

ESTER GJIKA  
**FILM PAS FILMI, UNË “E BIJA E” ...**  
KUJTIME, SHËNIME AUTOBIOGRAFIKE DHE JO VETËM

---

BOTIMET TOENA



ESTER GJIKA

## FILM PAS FILMI, UNË “E BIJA E”...

*Sequel i librit “Vit pas Viti” të babait tim, Viktor Gjika.  
(Kujtime, shënime autobiografike dhe jo vetëm)*



BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 978-9928-376-51-0

© Botimet Toena dhe Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

*Kushtuar gjysheve të mia, hyjni,  
dhe djalit tim, diell!*



## PARATHËNIE

Vështirë të gjendet në memoristiken shqiptare një libër kaq i drejtpërdrejtë ku një vajzë me emrin Ester ndriçon me kujtimet e veta ato lidhje të veçanta me prindërit e saj, madje një nga dashuritë më të thella, si ato atë e bijë, ku në rastin e saj hyn, mes për mes, kinematografia. Për të mos pritur shfletimin e faqeve të para të librit të saj, duhet thënë se Ester është vajza e Viktor Gjikes dhe Flora Gjika (Todoshit), një prezantim i denjë ky që në certifikatën e lindjes, por edhe si certifikim i parë i çdo shkrimtari. I çliruar nga çdo zbulim e lajlelule, të cilat nuk i ka jeta, por janë të shpikura, ky libër na thotë që edhe kinematografinë shqiptare ta vështrojmë më thjeshtë, si çdo gjë që e duam. Në një libër të mirë kujtimet nuk vijnë vetëm emocionalisht, si kanë lindur. Por duke qenë të sinqerta, ato bëhen të kristalta, madje fitojnë vetvetiu një mprehtësi të madhe. Pra, sinqeriteti në këtë libër nuk do të thotë naivitet, por rafiniturë artistike. Dhe gjithë ky skenëzim që zbulon një jetë tiranase, me një këndvështrim, ku e sotmja puqet me të djeshmen dhe e djeshmja me të sotmen, nëpërmjet besnikërisë së detajit, e bën edhe më të plotë jetën e një kineasti të madh si Viktor Gjika, që vazhdon t'i flasë publikut drejtpërdrejt me filmat e tij.

Ky libër na kujton se kur motivet e dashurisë at’ e bijë janë të palëkundshme, çdolloj këndvështrimi kthehet në një vërtetësi të rreptë, pasi çdo sekondë jete, cilado të jetë ajo brenda familjes Gjika, përmban një forcë detaji. Dhe midis arkeologjisë së kujtimeve, afreskeve historike, pasionit të rrëfimit, ky libër përbën një befasi në mënyrën e shtjellimit të jetës familjare të përditshme, të përzier me krijimtarinë. Rezultati? Vepra filmike që ka mbetur, dhe një vajzë brenda jetës tiranase, që duke treguar edhe për krijimtarinë e të atit, fiton lirinë e vet. Libri ndjek, hap pas hapi, etapat e xhirimeve të filmave, të krijuar prej Viktor Gjikës, pasi kjo ishte ritmika e jetës së një kineasti, që për absurd, duhet të dilte në pension në kulminacionin e pjekurisë së tij, sikur të ishte një balerin që në moshën 55-vjeçare nuk bënte më për skenën, sepse i ishin dobësuar muskujt. Dhe ndodh që rrjedha e tij filmike, si regjisor, përkon me lindjen e të bijës, që i qëndron pranë deri në fund të jetës, në momentet më të vështira. Po Ester Gjika ka vetinë të zbulojë plot talent një ditë dorë për dore me prindërit, kur gjatë xhirimeve të filmit “Horizonte të hapura”, ajo bëhet e ndërgegjegjshme se po jeton në ditën e një çifti të dashuruar, ditë që më vonë ajo do ta gjejë të reflektuar në sekuencat e vinçave që i afrohen njëri-tjetrit, si në një metaforë dashurie. Dhe mjafton ky interpretim sa artistik, po aq edhe i vërtetë për ngacmimet krijuese, për të dëshmuar talentin e saj, jo vetëm si një vëzhguese e madhe, por edhe si një zotëruese e rrëfimit. Ndoshta dikur i ka pasur edhe filmat e të atit si lodra. Dhe kjo e bën që t’i kundrojë filmat sot me distancën e një spektatoreje të veçantë.



Lexuesi do të gjejë në këtë libër, faqe pas faqeje, episode, që zbulojnë përtej historisë së kinematografisë, historinë e vajzës së një kineasti me reputacion të madh, gjithnjë e pranishme në krijimtarinë e të atit, edhe diku prapa sekuencave të filmave, ku edhe ca gjethe që fiksohen në kuadro duke rënë, ka ndodhur t'i hedhë dora e asaj vajze të vogël, që zëvendëson erën që fryn. Dhe befaz, së bashku me jetën e saj, ajo bëhet dëshmitarja e krijimtarisë filmike të një prej kineastëve më solidë të krijimtarisë filmike shqiptare, e profesionalizmit, të cilin ai ia dhuron gjithë botës shqiptare. Gjithë kjo magji filmike, që përmban edhe trukun, e bën vajzën e kineastit të krijojë një histori të filmit, të përzier me jetën e zakonshme, ku gjithçka është më e pranishme dhe më e afërt, madje duke e zbritur edhe filmin shqiptar në tokë, me vështrimin e saj të sotëm, me të gjithë imtësitë e tij që janë zbuluar dikur, si shenja të një analize nga më të detajuarat dhe plot të papritura. Dhe po aq befaz në këto kujtime del në dritë edhe mbikëqyrja dhe kujdesi i një bashkëshorteje, brenda një loje të bukur bashkëshortësh. Mund të shkruhen shume studime për krijimtarinë e Viktor Gjikes. Çdo bashkëpunëtor, koleg, aktor ose aktore, piktorë filmash që e ka njohur nga afër apo bashkëpunëtorë në grupet e filmit, apo për disa kohë si drejtor i Kinostudios, mund të rreshtojnë kujtime personale. Por libri tregon se si kujtimet e një vajze kineasti, në saje të sinqeritetit të saj, si në skaner, ndërhyjnë në të gjitha nënshtresat e kujtesës, deri në thellësitë që zbulon detaji mbi të gjitha fatet personale, pa të cilat as qyteti i Tiranës nuk do të kishte jetë. Aq sa

në këtë libër duket se vizatohen edhe skena vendimtare familjare që vërtetojnë se atë çka ofron jeta zor se mund ta arrijë imagjinata më e pasur, dhe aq më tepër klisjetë e gjykimeve standarde. Mund të quhet një libër i një dashurie nga më të shtrenjtat, i një vajze të rritur plot dhele nga ata që i kanë bërë kokën, si shprehen shqiptarët, një dashuri që në libër nuk shprehet me fjalën, por me ndriçimin e dhjetëra e dhjetëra sekondave e minutave të ngulitura të kujtesës, në detaje të mbetura në zemër, që tashmë jepen edhe për lexuesin. Mund të quhet edhe një libër lirie në rrugën dhe pjekurinë e një vajze, që fillon të gjykojë dhe çmon atë që ka fituar në jetë, lirinë e gjykimit dhe të veprimit, liri që ajo e ushtron edhe në këto kujtime. Spektatori i filmit shqiptar që ka ndjekur panoramën e kinematografisë shqiptare, mund t’i bëjë portretizimet e veta regjisorit Viktor Gjika, mbi të gjitha në sekuenca të filmit “Gjeneral Gramafoni”, ku ai guxon të vërë në gojën e aktorit të tij më të preferuar, Sandër Prosit, thënien më të famshme të Linkolnit. Me emocione që mund të dhurojë vetëm imazhi, çdo spektator mund të besojë gjithashtu se çdo diskutim mbi fatet e Shqipërisë dhe Kosovës, është nisur deri sot prej finales së filmit “Nëntori i dytë”, në mbërritjen me vonesë, të Isa Boletinit në Vlorë, ku qëndrimi emocional i Gjikkës shpreh një atdhetarizëm të pashoq. Ester Gjika ka privilegjin dhe mençurinë të dëshmojë një jetë jashtë dhe brenda fatit të këtyre diskutimeve kinematografike. Nga këndvështrimi i kësaj vajze, bota familjare në këtë libër vihet në epiqendër, si një betejë ndaj traditës më komplekse dhe dinjitetit piktoresk. Për të kuptuar më në detaj jetën e një kineasti si

Viktor Gjika edhe më domethënëse bëhet skena ku vajza e tij zbulon se çfarë rëndësie ka procesi krijues për një kineast shqiptar, i cili, para se të nisët në xhirimin e një veprë të re, qëndron në një qoshe dhomë vetëm me veten e tij duke iu falur Zotit. Përgjegjësi e madhe para publikut të ardhshëm? Ndhmë për të marrë forcë? Apo lutje për të dalë mirë deri në fund, edhe para një syri vëzhgues, që nuk pyeste për fatin e një familjeje të tërë? Të gjitha këto mund të përmbyllen, me veprat që flasin vetë, nga “Rrugë të bardha” tek “Yjet e netëve të gjata”, nga “I teti në Bronx” në “Në çdo stinë”, nga “Njeriu me top” në dokumentarët e pas viteve ’90.

Libri mund të quhet një zbulim i sekuencave të gjithanshme, ku lexuesi ndien se asnjë fjalë nuk është shkruar për të idealizuar, por për të treguar një jetë reale, me ndërlikime nga më të mëdhatë për hir të dashurisë bijë dhe at’, me autoritetin dhe përgjegjësinë e një shqiptari që ka arritur majat në një profesion të rrallë dhe që jep respekt të madh. Por libri dhuron edhe me tepër. Ndarjet e mëdha të familjeve shqiptare dhe përgjegjësitë që merren jashtë atdheut, një prej të cilave është edhe ky libër i një vajze, që sot i takon diasporës shqiptare, por që kthehet me këtë libër të lexuesi shqiptar për të treguar thesaret që plot përpjekje dhe sakrifica përmban jeta qytetare tiranase.

Ndaj, në këtë parathënie, që e afron lexuesin me përmbajtjen e librit, fjalët përmbjllëse dua të jenë për Esterin, autoren e librit:

Esi e dashur, ke shkruar me një gjallëri artistike të paparë dhe i ke dhënë dritë kujtimeve intime dhe publike të babait tënd, Viktorit.

Sigurisht që unë u emocionova që ti zbulon kaq jetë brenda një marrëdhënieje realiste prindër fëmijë, e cila më sjell para syve si karakter, si prindër Florën dhe Viktorin pa asnjë zbulim dhe gënjeshtër duke dhënë një kontribut të madh e duke thënë të vërteta njerëzore me aq dashuri dhe detaje. Ti zbulon një botë të tërë të të gjithëve ne! Të takonte si Gjika ta bëje këtë për vatrën që e bashkon aq mirë rreth vetes duke e skalitur. Duke skalitur mbi të gjitha lirinë tënde të bukur. Disa herë e kam ndërprerë leximin sot, në mes të natës, nga emocioni i madh që më ke dhënë. Rrëfimi yt tregon edhe formimin tënd individual e të një brezi, që merr përsipër jetën e vet. Vetëm ti mund të zbuloje kaq skena realiste të xhirimeve plot truke kinematografike.

Emocionet që përjetova gjatë leximit jam e bindur do t'i përjetojnë të gjithë ata lexues që do të zbulojnë kaq shumë jetë. Ti çel një dritare për të parë bukur, me realizëm, që të vazhdosh ta emanciposh këtë vend. Dhe e fundit, më befasove thellë, aq bukur e ke shkruar!

*Me dashuri,  
Natasha Lako*

## **PROLOG**

*Qershor, 2000*

- Esi xhan... sido që të vejë puna, çfarëdo gjë që të ndodhë, ti babin do ta kesh gjithmonë pranë. Mos e harro kurrë këtë!

Kthej kokën vrullshëm dhe vështroj tim atë si kurrë në jetën time. Hera e parë në tridhjetë e katër vjet që e dëgjoj të shqiptojë këtë frazë... u deshën më tepër se tri dekada për të dëgjuar atë çka kam ditur mirë e me qartësi brenda meje, por që pata dashur me gjithë shpirt të më thuhej, bile shpesh, gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës. Një lot i nxehtë, i rumbullakët, si margaritar i vogël, i tejdukshëm më bie nëpër faqe dhe, pa thënë as gjysmë fjale, mbështes kokën në supin e tij të dashur, të imët dhe familjar.

Një dallgë e lartë, e shkaktuar nga një mjet tjetër lundruer, trondit për një çast këtë moment intim, ndër më të bukurit dhe të paktët në marrëdhënien atë e bijë. Po udhëtojmë me një aliskaf nga Durrësi për në Bari, unë me shumë valixhe, me një sëmbim në zemër edhe sepse nuk kam djalin me vete, me ankth, por edhe me kërshtëri për jetën e re italiane, që më pret tej detit dhe që kam zgjedhur vetë.

Ndiej mall për tim atë që tani, pra edhe pse e kam pranë meje. Dhe është ndjesi pozitive. Kuptoj në atë moment

përgjigjen ndaj dilemës që më shoqëroi, për vite e vite, gjatë dekadave të para të jetës sime... pra arsyen e asaj rreptësie, ngurtësie dhe ngushtësie afektive me të cilën u rrita në fëmijëri. Fëmijë i vetëm, vajzë e regjisorit më të madh shqiptar, e ledhatuar me të mirat dhe avantazhet që më ofronte pozicioni social i prindërve të mi, i kisha të gjitha shanset të rritesha tekanoje, e llastuar, e pabindur, e pasjellshme, kapriçioze, problematike... dhe mënyra për të më mbrojtur nga këto të këqija paskësh qenë kjo.

Dhe unë e kuptova më vonë, goxha më vonë... çfarë As-i, çfarë Njesh-i kisha për baba, çfarë artisti kishim në familje, me çfarë punëtori të palodhur dhe të dedikuar, kokë e këmbë, pas artit pata fatin të ndaja ditët e mia, rritjen time, tryezën time, jetën time. Ndoshta nuk pata as mundësinë për t'ia shprehur qartë sa e vlerësoja dhe sa me fat isha, sepse derisa u ndërgjegjësova unë... rrodhi shumë kohë.

Ka qenë baba i sertë, i ashpër, rigoroz, me bindje të rrënjosura thellë në ndërgjegje dhe në shpirt, i vuajtur, por edhe për këtë i fortë, sepse i pati arritur vetë me forcat e tij të gjitha, nga zeroja, pa ndonjë trashëgimi familjare kulturore, artistike e aq më pak kinematografike. Gjithçka realizoi në jetë, si dhe pasuria e pashoq kulturore që i la kombit, janë fryt i punës dhe vetëm punës së tij, pa rekomandime, pa shtytje, pa ndihmë. Me një valixhe druri, shtatëmbëdhjetë vjeç, i trembur, i ndrojtur, i padalë, kapërceu pragun e shtëpisë së vjetër në Korçë, përqafoi prindërit, gjyshërit e mi të thjeshtë e të pashkolluar, dhe fluturoi... drejt Moskës, drejt botës së hapur, drejt artit, drejt ëndrrës.

Kaq shumë vjet u deshën që të kuptoja se pikërisht ato rregulla të forta, të ashpra, tek-tuk autoritare, në kufijtë e despotizmit, të imponuara në stilin tim të jetesës, të mënyrës së sjelljes, të mbrujtjes sime, nuk ishin veçse mënyra më e mirë për të formuar më pas femrën që u bëra, e brumosur me vullnet të pashoq, me këmbëngulje prej mushke (thoshte gjyshja...), me stil të pakrahasueshëm, me aftësinë për t’iu përshtatur të gjitha situatave dhe për të mbijetuar në çfarëdolloj konteksti e vështirësie, duke qenë kurajoze, trime e luftëtare. Dhe sidomos me vendosmërinë për të mos iu dorëzuar kurrë, asnjë dobësie dhe asnjë situatë të vështirë. Asgjë e pamundur për mua! Mungesa e ledhatimeve të tepruara, ndoshta, në një moment të parë e bën një fëmijë të ndihet jo rehat dhe i papërshtatshëm në jetë, sikur gjithçka i duhet ta arrijë me luftë e vështirësi. Por kjo në fakt e forcon, e kalit, e bind që për të pasur sukses në jetë, nuk duhet t’i lejojë vetes asnjë dobësi dhe duhet të shpërfaqë që ka më tepër forcë e guxim se të tjerët.

- Ba’, mos ki merak ti! Sido që të vejë puna dhe në çfarëdolloj situatë të pëlqyer apo të papëlqyer të ndodhem, mos harro kurrë që unë jam një Gjikë! Dhe ne Gjikajt kemi fibër fitimtari, nuk na tremb asgjë, përkundrazi, jemi ne që trembim fatin, vështirësitë dhe kë nuk sillet mirë me ne...

I kundërpërgjigjem kështu, me pak humor, shprehjes së ëmbël e të dashur të Viktorit, për të mos e bërë merak. Dhe si shpërblim marr një buzëqeshje të mrekullueshme atërore me atë shprehje fytyre që më nxit të jem, po ashtu, e fortë dhe e papërkulur si ai.

Por vetëm unë e di se çfarë kam në zemër. Boshllëk, hapësirë inerte përpara meje, asgjë të qartë, gjithçka për t’u nisur nga e para në jetë. Dhe për momentin, pa mundur të kem me vete djalin tim të mrekullueshëm dhjetëvjeçar, Polin e vogël, gëzimin më të madh të jetës sime.

- Dhe një gjë... Mënyra si do sillen të tjerët me ty, mënyra si do të të trajtojnë, varet nga vendi ku do ta pozicionosh ti vetë veten. Vendi ku do të vesh veten dhe djalin do t’i orientojë njerëzit rreth jush, dhe jo vetëm ata, në marrëdhëniet që do duan të kenë me ty. Pra, lart, sa më lart, vendose veten... Më lart se dhimbja, më lart se zilia, më lart se zemërimi, aty ku të tjerët nuk arrijnë dot! Je vajzë e zgjuar, kaq e bukur, në formë fizike të mrekullueshme, elegante, e mençur, me kulturë, me mendje të hapur, e sigurt në atë çka do dhe e vendosur që ta arrish. Ku mund të pozicionohet një femër e tillë, veçse lart?

Dëgjova me endje këshillat e tij që, këtë herë, nuk ishin direktiva apo udhërrëfime. Ishin fjalë të ngrohta që shprehnin dashurinë, krenarinë, respektin e tij ndaj vajzës së vetme...

- Jeta e vërtetë e një femre fillon kur ajo nuk ia vë më veshin mbushjes së viteve të moshës, por kur fillon përmbushjen e ëndrrave.

*Qershor, 2022*

Njëzet e dy vjet më pas, sërish djalin nuk e kam pranë, por jam e kënaqur që ka marrë fluturimin e tij nëpër botë, ka gjetur rrugën që i pëlqen (çuditërisht krejt të re dhe të



pashkelur në familjen tonë, merret me artin e kulinarisë dhe kimisë ushqimore). Dallgët e detit afër Romës më përkëdhelin ndjesitë me oshtimën e tyre joshëse, misterioze dhe të padeshifrueshme... thyhen diku aty pranë në rërën e shndritshme çuditërisht ngjyrë hekuri dhe diçka më sugjerojnë... Si dhe nga t’i filloj këta rreshta të dedikuar ty, njeriut më të rëndësishëm të jetës sime, që më solle në jetë e më mbrojte si deshe vetë, më dhurove ngjashmërinë fatlume për mua (*Esi, të ka bërë kuqua me letër kopjativ!*), formove karakterin dhe temperamentin tim, më përçove adhurimin për artin, kulturën dhe gjithçka të mirë e të bukur që ka kjo jetë... Dhe ndaj të cilit unë bëra gabime, shumë gabime, i krijova shqetësime, telashe, e trishtova jo pak, duke thyer disa herë, shpeshherë, tabu, rregulla, korniza e zakone të kohës. Ajo Eska e vogël, e bindur, kokulur, e dëgjuar dhe e urtë e fëmijërisë, u bë një Ester “paksa” rebele, e padëgjuar, impulsive, tepër moderne për kohën, duke ndjekur veçse çfarë i thoshte zemra dhe duke marrë drejtime shpesh të kundërta me ato klasiket e “gocave të mira”. Sepse kështu i pëlqente, i dukej se kjo ishte mënyra më e natyrshme dhe natyrale për të qenë e lumtur, duke ia bërë qejfin vetes, por pa menduar shumë për zemrat e thyera që linte pas, pa e vrarë shumë mendjen për etikë, ndjeshmëri dhe përgjegjësi.

Vështirë, shumë vështirë të shkruaj për veten.

E thjeshtë, tepër e thjeshtë të shkruash për ty.



## **PJESA E PARË**




## KAPITULLI 1

### **DEBATIK** *1961*

Pa fjalë.

Në atë kohë ekzistojë vetëm në mendjen dhe ëndrrat e prindërve të mi, nuk kisha ardhur akoma në jetë...

Foto të rralla, shumica të panjohura.







- O ba', po si po qëndron në këtë karrocën e Colit ti, duke mbajtur dhe gjithë atë telekamerë në sup? Është në ecje e sipër karroca apo ka qëndruar në vend? - e pyes tim atë në momentin e parë, diku nga mesi i viteve '80, kur më bie në dorë kjo fotografi e jashtëzakonshme, që shpjegon pa fjalë dhe më tepër se mijëra fjali se si punonin kineastët e atyre kohërave, me mjete primitive dhe të sajuara.

- Esi, xhan, jam i lidhur me rripa leckash dhe nëpërmjet një litari me pjesën e poshtme të stolave të karrocës, ndërsa më mban një copë dërrasë ku kam mbështetur prapanicën... Karroca është në lëvizje, vetëm në këtë mënyrë mund të inkuadroja me saktësi dhe vërtetësi portretin e Colit, sytë e tij të shndritshëm, shprehjen e fytyrës në lëvizje...

Në heshtje mbaj në dorë këtë imazh të rrallë ndërsa vështroj me admirim dhe mallëngjim tim atë. *Ky është thjesht pasion, vërtet pasion, mendoj. Pasion dhe dashuri për atë që quhet profesioni yt.*







## KAPITULLI 2

### **KOMISARI I DRITËS**

1966



Kam lexuar diku fshehurazi në një letër të ngrohtë dashurie të tim eti drejtuar mamasë sime të bukur, Florës, që lindja ime ka qenë shumë e vështirë, me vuajtje të mëdha të tmerrshme, dhimbje të padurueshme dhe të gjata pa fund, ulërima që dëgjoheshin në të gjitha katet e maternitetit, lot pa fund... nuk doja të dilja.

Më në fund, zhbirova dritën dhe vendosa t'i jap fund vuajtjeve të sime mëje dhe me një hov iu dorëzova jetës. Fillova rrugëtimin tim, ja, si ai komisari i filmit që po xhirohej ndërkohë, dhe që përshkonte malet e madhërishtme me pemë të larta, që sikur e mbronin nga trysnia e qiellit të lartë e të pafund. Mua do të më mbronin hija e freskët e babait dhe dora e tij e ngrohtë do të më tregonte e do të më drejtonte në rrjedhën e jetës. Ndërsa sytë e bukur dhe buzëqeshja femërore e Florkës do të më shoqëronte që aty e deri në fund të jetës së saj, duke u bërë burimi i parë i frymëzimit dhe përkujdesjes, i rrugëtimimit dhe arritjeve...

Ndërsa ajo vetë tregon që kur doli nga materniteti, pak ditë pasi u rimëkëmb nga mundimet e lindjes, e kuptoi ç' lumturi dhe hare do t'i dhuronte kjo qenie e vockël, që merrte frymë si njeri normal (i dukej çudi) pranë veshit të saj. “Kur dëgjoj atë ssss, ssss, ssss... frymëmarrjen e nxituar, sikur të jetë duke rendur, të çupkës sime, edhe kur fle, them me vete hallall vuajtjet dhe mundimet e lindjes! Kam sjellë në jetë një jetë tjetër, një mrekulli të quajtur Ester.” Sa emër i bukur dhe femëror! Do ta kuptoja më vonë, vite më vonë, sa me fat jam që mbart këtë emër domethënës. (Princesha Ester e *Biblës* që shpëtoi popullin e saj apo “Ester” personazhi i Honore dë Balzak) dhe sa do të më ndihmonte ky emër i veçantë vite më vonë në jetë, sidomos në rrugëtimin tim jashtë Shqipërisë. Në shkollë, sidomos në atë tetëvjeçare, pata probleme, sepse askush nuk e kishte dëgjuar këtë emër. Bile, shumica e mësueseve, sidomos zëvendësuese, e merrnin për emër mashkullor meqë nuk mbaronte me “A” dhe më ngrinin shpesh në dërrasën e zezë për të më pyetur,

se donin të shikonin kush ishte “ky” nxënës me këtë emër të padëgjuar. Shkurtimin në Esi e kam nga gjyshet e mia të shtrenjta, që nuk e shqiptonin dot të plotë...

FILM PAS FILMI, UNË “E BIA E”...



\*\*\*

Prindërit e mi kanë qenë ndër të rinjtë më të bukur të moshës së tyre... Viktori i sapokthyer nga Moska ku pat mbaruar studimet për kinematografi, djalosh biond, një



vështrim i thellë që të shkundte zemrën, elegant, i zgjuar dhe i ditur, njohu Florën e bukur në dasmën e një kushëriri në Korçë dhe mbeti i shtangur nga hijeshia e saj, nga buzëqeshja rrëzëlluese, nga beli “i këputur” dhe trupi i përkryer, nga mënyra e komunikimit, nga sytë lozonjarë, nga hunda perfekte... nga gjithçka! Ishte goditje vetëtimë drejt e në zemër, me shikimin e parë. U vështruan, u njohën, u dashuruan, u fejuan, u adhuruan, u martuan, u respektuan, u shkrinë me njëri-tjetrin, u amalgamuan, u mbajtën për dore tërë jetën.

Në Tiranë banonim në pallatin e madh e të gjatë përballë kullave pranë sheshit “Avni Rustemi”. Në katin e parë që binte në një tarracë të gjerë e plot hapësirë, të ngritur në nivel. Sigurisht nuk i mbaj mend vitet e para të jetës, por më ravijëzohen kujtime të mjegullta nga kopshti i fëmijëve ku shkoja gjatë ditës... Kopshti ishte pak metra larg shtëpisë dhe nga ballkoni dukej mirë. Kam të skalitur në kujtesë Florën e bukur, që më ndiqte me vështrim dhe më përshëndeste me dorë derisa hyja në oborr, e shoqëruar nga babi. Ashtu si kam të ngulitur në kujtesë momentin që mami shfaqej nga ana e rrugës kur kthehej nga puna dhe unë, duke ditur orën, prisja në ballkon të shihja imazhin e saj të mrekullueshëm, që ecte me hap të sigurt, të vendosur dhe të shpejtë, që të mbërrinte sa më parë në shtëpi. Pastaj rendja në anën tjetër të apartamentit, në kuzhinë, dritarja e së cilës binte në tarracën e madhe të pallatit, dhe që aty shikoja Florën teksa ngitej shkallëve; kalonte pikërisht përpara asaj dritareje, dhe pas pak sekondash i binte ziles së derës. Unë ndërkohe kisha përgatitur sallatën jeshile marule, duke

e larë gjethe për gjethe, një kujtim i fiksuar i fëmijërisë, larja e asaj lloj sallate, sepse sa herë gjeja ndonjë kërmill të vockël nëpër gjethe, më thoshin që ishte provë e freskisë së marules. Pastaj e shtrydhnim me dorë, ajo mbetej gjithsesi e lagur (e papranueshme për rregullat e kulinarisë, do ta mësoja vite më vonë, kur u transferova jashtë Shqipërisë) dhe i grija sipër qepka të njoma të prera hollë.

Kishim një apartament modest, të thjeshtë... por sa të bukur dhe të mobiluar me shije. Unë e kam adhuruar atë shtëpizë, sa isha e vogël kisha krevatin tim në dhomën e gjumit të prindërve, pastaj kur fillova të bëhesha zonjushkë, pata dhomën time të bukur, ngjyrëshumë, të freskët, që dilte në ballkonin e madh e të gjatë, i cili përqafonte edhe dhomën e prindërve. Mbaj mend mami Florën që qëndiste, i jepej shumë për të qepur, gjithmonë me kutinë e penjve nëpër duar... bëri atëherë një abazhur të mrekullueshëm duke i përshtatur copën material të një robdëshambri me të qepura sfungjeri si rombe. Doli aq i bukur sa filluan edhe shoqet e saj të shqepnin fustane e këmisha për të bërë abazhurë. Varfëri... kishte shumë pak mall në treg dhe amvisat e zgjuara sajonin me ç'të mundnin.

Ashtu si mbaj mend edhe dy rafte që im atë sajoi në atë dhomëz timen, duke shfrytëzuar disa telajo të krevatit tim të vjetër, ku kisha fjetur ato pak vite në dhomën e prindërve, dhe që tashmë ishte dhe i vogël, e nuk më nxinte më. Sesi e gjeti mënyrën Viktori t'i lidhte ato telajo me një litar të pastër, të bardhë dhe, duke bërë nyjat në skajet e tyre, i vari në mur njërin sipër tjetrit në distancë. Unë aty radhita librat e shkollës dhe ato që lexoja në kohën e lirë. Sa e lumtur kam

qenë në atë dhomë, aq të thjeshtë, por të ngrohtë, intime, të pastër dhe mbi të gjitha personale, E IMJA.

Nga ajo dhomë komunikojta me shoqkat e mia. Me Bonën (Valbonën) që banonte në apartamentin përballë (pra, dhoma e saj ishte ngjitur me timen), kishim krijuar një kod sekret: Kur i binim murit tri herë ishte urgjencë, pra duhet të dilnim në ballkon e të flisnim, nëse i binim katër herë, dy plus dy, donte të thoshte që prindërit ishin në shtëpi, pra nuk mund të flisnim lirshëm; nëse i binim dy herë dmth., që duhet të merrnim në telefon njëra-tjetrën, apo kur i binim katër herë, me tre plus një, donte të thoshte që rruga ishte e lirë, prindërit ishin jashtë për vizita, pra mund të hynim në shtëpitë e njëra-tjetrës. Me Edën, Nilën, Danën që banonin në kate të tjera bënim thashetheme nga ballkonet, të cilat njëherë Viktori i dëgjoi nga dhoma e tij dhe erdhi me vrap në timen, më kapi prej veshi dhe më bëri për një lek: “Mos të të dëgjoj më të llapashitesh për të tjerë njerëz në mungesë të tyre! Nuk ka gjë më të shëmtuar se thashethemet, sepse ti nuk i jep mundësinë njeriut për të cilin po flisni, të kundërpërgjigjet. Është gjëja më e padrejtë, një lloj tradhtie...”. Ky ka qenë leksioni numër Një i mirësjelljes që mbaj mend nga im atë. Me lot në sy nga shpulla e nxehtë që më krisi në fytyrë, e ngulita në mendje këtë mësim, që më pas në jetë do të vërtetohej shumë i vyer.

\*\*\*

Një episod i këtij filmi që më është skalitur në mendje është momenti kur klerikët e bandës reaksionare po i presin



mësueses flokët e bukur biondë... (e luajtur me mjeshtëri nga Roza Anagnosti, aq e bukur dhe fare e re në atë kohë). Sa më trondiste ai moment dhe qaja gjithmonë, derisa u rrita pak dhe Viktori më shpjegoi që ajo ishte vetëm parukë dhe në fakt nuk po i prisnin vërtet flokët e aktore. Me kalimin e viteve, ai episod madje u bë edhe burim humori, sepse e ngacmoja tim atë duke i vënë në dukje që, në fakt, paruka ishte detaj mjaft i kuptueshëm dhe i dukshëm në film, sepse në momentin që hyjnë gërshtët e mëdha në gërshta, paruka lëviz dhe jo pak, aq sa kuptohet menjëherë që nuk janë flokët e vërtetë që po priten. Ia kam bërë kaq herë këtë vërejtje dhe pakujdesi të grimiorit apo të vetë regjisorit dhe të operatorëve, aq sa në një moment u inatos, madje sikur u fye dhe më tregoi vendin me ashpërsinë e tij tipike në momente inati.





# FILM ARTISTIK SHQIPTAR

## “KOMISARI I DRITES,”



### PERMBAJTJA

—KOMISARI I DRITES—. Është artistik kështu përjetë dhe veprimtarisë patriotike të mbështetë të popullit. Nëse Gjoka dhe bashkëkohësve të tij, të cilët me shprehje e partitë, dhe kontributin e tyre të çmueshëm për të përhapur dritën e dituarit edhe në skajet më të largëta të Atdheut.

Filmi, për trajtim subjektiv nga revolucioni ynë i pashembullt kulturor, ndeshjen e shpirtit midis përfaqësuesve të së rëndë dhe mbështetësve të arsisë, patriotit, injorancës, anëtarëve të luftës për dritën e përparimit të gjendjes në një shtet, që u shpallën ditë e para pas çlirimit të vendit tonë.

**Skenari: LAZAR SHIPI**  
**Regjler-operatorer: Ushmitër Anagnosti, Viktor Gjika**  
**Fotograf: Ksenofon Dilo**  
**Kompozitor: Tish Dajçe**  
**Operator i zërit: Keço Tullko**  
**Drejtor i filmi: Bajaz Kolonaci**

**INTERPRETOJNE**  
**RIKARD LIARJA, HODER LUCA, BOJA ZHIZINA,**  
**HODER PRELA, PRENG LËNKURDA, etj.**

PRODHIM I KINOSTUDIOS  
 "SHQIPERIA E RE" 1980





### KAPITULLI 3

## **HORIZONTE TË HAPURA**

1968



Ah, po... diçka nga xhirimet e këtij filmi e mbaj mend! Edhe pse isha vetëm dy vjeçe. Është një fotografi e mrekullueshme e familjes sime përballë digës “Adem Reka”, personazhit kryesor të filmit. Unë, e vockël, sa dukem si pikë e largët, midis prindërve të mi të mrekullueshëm në atë foto, që më mbajnë për dore nga të dyja anët. Edhe një tjetër nga mbrapa me mamin përsëri, me digën në sfond...

jemi duke pritur të mbarojë xhirimet babi. Të bukur pa kufi, të lumtur pa fund, të dashuruar deri në marrëzi, elegantë e të hijshëm deri në thjeshtësi. Është një nga fotot e familjes që dua më shumë... Më frymëzon gjithmonë dashuri, kujdes, përkëdhelje.

Më vonë do mësoja që edhe im atë ishte frymëzuar nga ai moment familjar për të xhiruar ditën e nesërme, skenën e vinçave që, të vënë në punë e duke u rrotulluar e lëvizur, duken sikur puthen, sikur grinden, sikur i kthejnë kurrizin për një moment njëri-tjetrit, për t’u pajtuar sërish më pas e për të bashkuar “sqepat”.


Në po atë periudhë, pushime të bukura pranë detit të Durrësit, me miq e shokë të prindërve, në mos gaboje kishim komshinjtë familjen e Andrea Ziut, babait të Irenës (gruas së ardhshme të Albert Mingës) dhe të Dianës, kompozitores së ardhshme. Në ca kabina të varfra në zonën e “Hekurudhës” (si quhej) prej dërrase, tipike “socialiste” me WC jashtë dhe të përbashkët. Por ishte hapësirë “me mik”, sepse gjendej afër zonës së “Breshkës” ku bënëin pushimet rinia më moderne dhe e bukur e kohës, sportistë, artistë etj.

Që në mëngjes herët, nxitonim të zgjoheshim dhe, me peshqirë në supe, rendnim drejt çezmave të përbashkëta, të vënë në rresht horizontal, bile, preknim bërrylat e njëri-tjetrit kur lanim dhëmbët. Në ato kohëra, kabina jepej me autorizim nga qendra e punës dhe kishte brenda dy krevate tip marinari, të pajisura me dyshekë leckash dhe mbulesa, të cilat përdorëshin në 15-ditëshin që vinte nga një familje tjetër... Diku nga mesi i viteve ’70, kabina kishte të përfshirë edhe një furnelë vajguri. Kush kishte mundësi



sillte nga shtëpia edhe frigoriferin që mbartej me peripeci pa fund nëpër trena. Ndryshe ushqimet mbaheshin në një dollap të vogël me dy kanata dhe, imagjinohet, me tërë atë vapë, shpesh kalbeshin apo zinin miza... dhe i hidhnim.

FILM PAS FILMI, UNË “E BIA E”...



Por ishim të lumtur. Mami më këndonte “O moj trëndafile sa e bukur je” dhe unë hidhja hapat e vegjël nën ritmin e muzikës duke korrur admirimin e të gjithëve. *Pupu do na e marrin çupën në sy*, çirrte faqet gjyshja ime. Që këtu do të lindte edhe dashuria ime e pakufi për vallëzimin në përgjithësi dhe kërcimin modern në veçanti. Nuk do të kishte mbremje klase, më pas disko apo më pas akoma, kurs kërcimi në palestër ku unë të mos merrja pjesë dhe të mos lavdërohesha nga të gjithë... E kam në gjak, edhe tani. Sapo dëgjoj muzikë, që është për mua si gjymtyrë e shtuar, si zgjatim i një shqisë dhe i shpirtit, si nerv që vihet në lëvizje dhe pa dije, trupi im, krejt qenia mobilizohet dhe fillon të lëvizë në atë ritëm. Kudo që të jem, jo vetëm në pushim, por edhe në punë. Është e pamundur për mua të rri statike. Muzika ka efekt magjik mbi mua... intrigues, misterioz, herë-herë të frikshëm, sepse rrëmben komplet kontrollin e mendjes, të shpirtit dhe të trupit tim.





Ndërsa babai xhironte në port (më pas u bë traditë që sa herë shkonim në Durrës, për plazh apo edhe thjesht për një drekë, ai do të kalonte se s’bën nga porti për të parë digën... kështu pa arsye, por u lidh shumë me të, si të ishte një qenie e gjallë), pra, ndërsa ai merrej me filmin unë ndiqja me kërshtëri buburrecët e rërës, insekte që më kanë intriguar gjithmonë. Luaja me ta, i vija në rresht dhe në garë me njëri-tjetrin ose i mbuloja me një kodër rëre dhe zbavitesha aq shumë kur gjenin rrugën dhe dilnin. Më ka pëlqyer gjithmonë të luaj me qenie të gjalla, jo dhe aq me lodra pa jetë. Prandaj jam e dashuruar pa limit me kafshët, të çfarëdo lloji dhe përmase. Për mua dhe djemtë e tezes sime, Gencin dhe Edin, lojërat e fëmijërisë kanë qenë të lidhura pashmangshmërisht me Korçën, ku kalonim gjithë pushimet e verës, por mbi të gjitha me kafshë shtëpiake: qenushë, mace, pëllumba, lepuj pa fund, e mes tyre i paharruari Vinçenzo, për të cilin Genci ndërtoi një kolibe “luksoze” ne pastronim përditë nga kakërdhitë. Pale kur dilnim të gjithë nëpër mëhallë dhe më tej të mblidhnim qumështorka (quheshin barishtet e freskëta që Vinçenzo i pëlqente shumë).

Trauma e parë dhe më e madhe e fëmijërisë sonë ka qenë therja e atij lepurit aq të bukur e të zgjuar... Tani, për atë punë e kishte marrë gjyshja jonë e shtrenjtë, Artemisia, për ta majmur e pastaj për ta ngrënë. Por siç mund të merret me mend, ne fëmijët nuk e vumë në gojë (edhe pse tava me mish lepurit ishte një pjatë e rrallë dhe shumë e çmuar) dhe therja e atij lepurit na vrau të gjithëve, aq shumë, sa nuk pushonim së qari.

\*\*\*

FILM PAS FILMI, UNË “E BIAJË”...

Që të kthehemi te filmi “Horizonte të hapura”, babai im në atë kohë 31-vjeçar simpatik, karizmatik dhe me energji të pasosur (që nuk do t’i shteronte kurrë, deri ditët e fundit të jetës) mungonte shpesh në shtëpi në periudhën e xhirimeve, e më pas të montimit, kur rrinte edhe gjithë natën i kërrusur mbi moviolë. Edhe kur regjistrohej muzika e filmit, ishte i pranishëm në çdo sesion. Flora e bukur, vetëm 28-vjeçare, në atë kohë punonte në ATSH, rrinte me mua fëmijë në shtëpi, vetëm dhe, e kemi marrë vesh më pas, e kishte shumë frikë vetminë. Më tregonte, kur u rrita, që më trime isha unë fëmijë se ajo. Dhe përpiquej të rrinte zgjuar derisa të më zinte gjumi mua, por, në më të shumtën e rasteve isha unë që, me gjysmë zëri, pëshpëritja: “Uh, më në fund, e paska zënë gjumi mamin!”, dhe shuaja abazhurin. Sa ëmbëlsi ndiej kur e shoh tani me imagjinatë këtë skenë!



Për Viktorin ky ishte i pari film edhe si regjisor, edhe si operator. Thonë që kamera e tij, fotografia, inkuadrimet, pra gjithë puna si operator në këtë film, sidomos në skenat e xhiruara në port, janë të shkëlqyera, inovative, të papara në të kaluarën. Xhirime të vështira, im atë i lidhur me litar në majë të digës për të xhiruar portretin e Uranit nga kabina e drejtimit të vinçit... më kujton atë peripecinë tjetër të ngjashme, gjatë xhirimeve të “Debatik”, ku iu desh të lidhej edhe aty me ca lecka në karrocën e Colit, në ecje e sipër, për ta xhiruar më mirë fytyrën e tij dhe skenën në përgjithësi. Por këtu ishte akoma më në rrezik, i varur dhjetëra metra mbi tokë. Pa harruar që bëhej fjalë për vitet '60, kur mjetet teknike në dispozicion ishin të pakta, të varfra dhe pa teknologji. Ky fakt duket edhe në grimin e aktorëve, edhe në zhurmat dhe zërat që kumbojnë të thatë, sepse procesi i dublimit zhvillohej në dhoma jo shumë të përshtatshme, që nuk arrinin të simulonin kumbimin e tyre natyral në hapësirë. Megjithatë objektivi i Vitjas, dinamik, gati gjithmonë në lëvizje, nga një portret te tjetri, por edhe i fokusuar aty ku duhej, i ndjeshëm ndaj karaktereve dhe figurave të personazheve, ka krijuar një kryevepër kinematografie. Në skenat e fundit të filmit, kur shpërthen furtuna mbi mol, babai tregonte që për të simuluar rrebeshin me furtunë, i është dashur atij vetë të përdorte kova të mëdha uji për t'ua hedhur personazheve duke imituar shiun e fortë dhe të dendur.

Vlerësimet e larta që iu bënë filmit, ishin dyfish të çmuara për tim atë. Kjo, sepse ishte edhe momenti i ndarjes profesionale nga Taqo (Dhimitër Anagnosti), shoku i

ngushtë i studimeve dhe i rrugëtimit kinematografik, secili në rrugën e vet. Në jetë, ata ia dolën që të mbajnë dhe të kultivojnë një miqësi të bukur, që u transmetua edhe te familjet tona më pas, sidomos te ne, vajzat e tyre, unë, Juna dhe Era, me të cilat kam kujtime të mrekullueshme. Me Junën komunikoj edhe sot e kësaj dite me shumë dashuri.

Vonë, nga mesi i viteve '80, pastaj miqësia e baballarëve tanë u kris... për një arsye apo për një tjetër. Gjëra që ndodhin, mund të jenë të natyrshme, por kam dëgjuar në shtëpi tim atë të shprehet më tepër se një herë i fyer, i lënduar e i trishtë dhe me sytë që i shndritnin nga një lot, që nuk ra kurrë, i zhgënjyer në jo pak raste nga venitja e asaj miqësie të gjatë dhe të bukur.

Do të kishte dashur Vitja një mbështetje, një fjalë të mirë, një sup ku të mbahej në momentin kur u nxor në pension (vetëm 55 vjeç në kulmin e energjive dhe forcave krijuese) pikërisht kur disa miq të tij ishin në pozita të larta qeverie ... ndoshta dhe thjesht konicidenca, por jo të këndshme, që minuan përfundimisht disa miqësi e lidhje shoqërore të hershme.

Unë personalisht e kam ndier disa herë atë ftohtësi që u krijua, e përjetova keq, sepse Junën e doja fort dhe me Erën e vogël zbavitëshim shumë duke regjistruar në magnetofonin e shtëpisë sime koncertet, recitimet, skeçet... disa herë edhe të detyruara me pahir nga Vitja dhe Taqo, por sidoqoftë janë shirita, të cilët kanë mbetur dhe unë po përpiqem t'i digjitalizoj që t'i kemi në arkivat e familjeve tona. Por pastaj nuk ia vura veshin shumë ftohtësisë, sepse secili ishte i zënë me punët e veta, me probleme, halle,

por edhe gëzime, arritje e gjithçka përbën atë që quhet jetë. Gjithsesi, konfirmimin e asaj thyerje e mora kur u ndërpre në vizitat në shtëpitë e njëri-tjetrit, kur nuk pashë në dasmën time familjen Anagnosti (ndoshta nuk ishte ftuar), kur fillova të mos lidhesha dot më me Junën dhe sidomos, kur kam lexuar komentin e Taqos në librin e tim eti “Vit pas viti”... Ndërsa të gjithë kolegët, miqtë, dashamirës, artistë u shprehën aq bukur duke analizuar karakterin, figurën dhe veprën e babait tim, në pjesën që i takonte Dhimitrit lexova vetëm një koment të thatë mbi “Nëntori i dytë”, edhe ai jo fort dashamirës, asnjë fjalë të mirë për tim atë, asnjë vlerësim, asnjë dhembshuri që iku aq shpejt... Eh!



## KAPITULLI 4

### I TETI NË BRONX 1970



Mevlani i bukur, i talentuar dhe i veçantë, do të hynte në zemrat e të gjithëve (por edhe si dhëndër në familjen tonë) me rolin kryevepër të Ibrahim Kovaçit. Unë atëherë isha vetëm katër vjeçe dhe nuk e mbaj mend momentin kur u bë njeri i shtëpisë, pra që kur fillon memoria ime e familjes Mevlanin e kam të rrënjosur në zemër dhe imazhin e tij në kokë, pa data, vite, ndodhi apo momente. Ai ka qenë gjithmonë me ne, unë nuk mbaj mend moment të jetës kur

ai nuk ka qenë prezent, fizikisht apo jo fizikisht, nuk kishte rëndësi. Madje, më duket sikur kam njohur më përpara atë sesa Tashën (Natasha Lako) tonë të dashur, që është vajza e dajës së mami Florës.

Që nga ajo periudhë, por ndoshta më theksuar pas viteve '80, emri i Shanajve do të bëhej pjesë e pandarë e jetës së Gjikasve, me ecejake pa fund, vizita të shpeshta në shtëpitë e njëri-tjetrit, pushime verore së bashku, miqësi të fortë midis fëmijëve, bashkëpunime profesionale mes të rriturve, ndarje momentesh gëzimi, por edhe hidhërimi. Flora vdiste ta kishte Mevlanin në çdo tryezë, se “më pëlqen sa s’ka muhabeti i tij”, ai dinte të bashkëbisedonte këndshëm, me humor, të bashkëbisedonte me vërtetësi dhe pa bërë lajka. Mevlani atë që mendonte, ta thoshte, pa rezerva. Nga ana tjetër, Tasha jonë e talentuar ishte kripa e çdo takimi. Poeteshë dhe artiste e lindur, në mendjen e saj të veçantë mua më dukej sikur ekzistonte një botë paralele me atë realen, të vërtetën... Aq bukur i shtjellonte subjektet në romanet e saj, në poezitë shpesh jo të deshifrueshme kollaj, nëpër intervista dhe artikuj. Sikur atë çka ndodhte në botën e saj intrigante të mbushur me art, magji dhe enigmë, ajo mundohej të na e përçonte me takt dhe mirësjellje neve, tokësorëve, që popullonim një botë banale, krejt ndryshe nga ajo ku jetonte me imagjinatë Tati (siç e thërrisnim me përkëdheli). I është gjendur gjithmonë pranë prindërve të mi, në çdo nevojë (të paharruara tenxheret me supë, që u sillte kur ishin sëmurë), me dedikim e kujdes të ngrohtë dhe këtë veti njerëzore të saj e kam adhuruar tërë jetën, edhe sepse unë nuk kam arritur kurrë të jem si ajo.



Gjithsesi, kam pasur gjithmonë përshtypjen se nga ana e Mevlanit kishte një prirje konkurrence të shëndetshme ndaj Vitjas, një lloj shpirti gare, që nuk dëmtonte asnjërin. Përkundrazi, nxiste ambicie kulturore dhe profesionale, të pasur me iniciativa dhe frymëzim krijimtarie, me biseda interesante pa fund. Dikur, dikush do me vinte në dukje që, ndoshta, ajo prirje konkurrimi edhe mund të merrte emrin “zili”, apo që një fill i hollë e ndante kufirin midis kësaj fjale në thonjëza (për të cilën unë kam pasur gjithmonë antipati) dhe konceptit të ambicies së shëndetshme. Por nuk ka qenë kështu. Respekti dhe dashamirësia reciproke midis tyre ishte aq e dukshme, gati e prekshme fizikisht, sa edhe ndonjë moment fërkimi, sidomos gjatë bisedave për politikën apo për preferencat partiake, kthehej në humor dhe nuk bënte tjetër, veçse forconte miqësinë e salduar me çelik midis Gjikaljve dhe Shanajve. Kjo gjë do të vlente edhe për ne fëmijët.



FILM PAS FILMI, UNË "E BIAJË"...

